



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:234764

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06181725

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0447-A0001

Paditëse

K A me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin G A, Prishtinë

Kundër:

E paditura/Ankuese

SH.P.K. “NewCo Grand Hotel” (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1283, të datës 19 korrik 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 19 shtator 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1283, i datës 19 korrik 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 8 korrik 2015, paditësja kishte parashtruar një ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN173-0270 të datës 25 qershor 2015, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për tetë (8) pagave të papaguara në shumën prej 2,257.09 euro, për periudhën kohore nga dhjetor 2011- 6 gusht 2012, ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar kërkesa ishte parashkruar dhe nuk ka asnjë provë që parashtruesja e kishte dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent më parë.

Në ankesë paditësja kishte theksuar se kërkesën e kishte paraqitur me datë 18 mars 2015 që ishte brenda afatit ligjor e jo pas afatit të parashkrimit siç pretendon AKP-ja. Në shkresën e datës 7 gusht 2012, zëvendës drejtoresha e AKP-së M T kishte deklaruar se të gjitha pagat e papaguara do të shqyrtohen nga AKP-ja në mënyrën më meritore nga Autoriteti i Likuidimit në procedurë të përsheptuar dhe se gjatë shqyrtimit do të respektohen procedurat ligjore, mirëpo që në praktikë ndodhë gjithnjë e kundërta duke iu refuzuar kërkesat legjitime që kanë të bëjnë me ushqimin e familjes së tyre të cilët nuk kanë të ardhura tjera për jetë. Andaj, kishte propozuar që të anulohet vendimi i AKP-së nr. 5556/2015 dhe paditëses t'i njihet e drejta në kompensim për paga të papaguara në shumën prej 2,257.09 euro si dhe t'i paguhen shpenzimet gjyqësore të caktuara nga gjykata.

Ankesës i kishte bashkëngjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN173-0270 të datës 25 qershor 2015, autorizimin për përfaqësim, kopjen e letërnjoftimit të paditëses, kopjen e librezës së punës, një njoftim për paditësen nga AKP i datës 2 shkurt 2015 me nr. prot.845/15-out, një kontratë pune me nr. 55 e datës 3 janar 2007 ndërmjet paditëses dhe të paditurës, një kontratë pune me nr. 55 e datës 3 prill 2007 ndërmjet paditëses dhe të paditurës, një kërkesë nga punëtorët e N.SH-së për AKP-në me nr. 379 e datës 9 tetor 2014, një kërkesë nga Shoqata e Pavarur Sindikale e Grand Hotel për AKP-në e datës 13 shkurt 2015 me nr. 943, një kërkesë për kompensimin e pagave, kontributeve të trustit pensionale të mbetura nga New Co Grand Hotel sh.p.k, e datës 20 shkurt 2012, një Aktvendim i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të datës 16 mars 2012, Përgjigje në shkresë e AKP-së e datës 7 gusht 2012, njoftim të datës 26 mars 2012 nga Shoqata Sindikale e Grand Hotel për AKP-në, Vendimet e Shoqatës Sindikale të Grand Hotel të datës 2 prill 2012 dhe 27 korrik 2012, listat me kontributet e papaguara për muajin 12/2011, 2/2012- 08/2012 si dhe 12/2011 deri me 08/2012.

Me datë 1 shkurt 2023, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në ankesën e paditësit në të cilën kishte theksuar se parashtruesja nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2. të Ligjit për DHPGJS-në i cili parashikon se ankesat e dorëzuar në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje, theksohet se kërkesa e paditësit do të duhej të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimi. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë, e paditura i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar, ndërsa të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur 5 formularë për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim të parashtruar nga paditësja, dy lista të lëshuara nga një komision ku pasqyrohet paga neto më pak e paguar sipas kontratës nr. 55 të paditëses K A e datës 11 nëntor 2014, kopjen e letërnjoftimit të paditëses, kopjen e librezës së punës së paditëses, pasqyra e trustit të paditëses, pasqyra e historikut të xhirollogarisë bankare të paditëses, kontrata e punës ndërmjet paditëses dhe të paditurës e datës 1 janar 2015, kontrata e punës ndërmjet paditëses dhe të paditurës e datës 3 prill 2007, kontrata e punës ndërmjet paditëses dhe të paditurës e datës 3 janar 2007, njoftimi për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes nga AKP për paditësen, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN173-0270 të datës 25 qershor 2015 si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 19 korrik 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1283 kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditëses duke ndryshuar vendimin e AL-së ashtu që kishte obliguar të paditurën që paditëses në emër të pagave të papaguara t'ia paguaj shumën prej 2,051,90 euro për periudhën dhjetor 2011 deri me 6 gusht 2012, ndërsa pjesën e mbetur të kërkesës mbi shumën e gjykuar e kishte refuzuar si të pabazuar. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se gjykata me provën e dokumentit të listës së pagave të papaguara për periudhën e muajve dhjetor 2011 deri në gusht 2012 paditëses me nr, rendor 55 i janë llogaritur pagat në shumën prej 2,051.90 euro ndërsa përkundër kësaj llogaritje ajo kishte kërkuar shumën prej 2,257.09 euro, listë kjo e nënshkruar nga drejtori financiar i N.SH-së. Jo vetëm me këto lista por edhe me prova tjera gjykata kishte konstatuar se paditësja ka qenë punëtorë e N.SH-së dhe kjo e fundit i ka borxh pagat e papaguara në shumën e aprovuar nga gjykata. Tutje, gjykata kishte vlerësuar se këto prova i ka edhe e paditura dhe e paditura në përgjigje në mbrojtje nuk është deklaruar në lidhje me prova por vetëm me faktin se kërkesa është parashkruar, përkundër faktit

që punëtorët në vazhdimësi kanë kërkuar pagimin e pagave tek AKP-ja dhe AKP-ja kishte premtuar se për kërkesat e tyre do të vendosen meritorisht. Gjykata kishte vlerësuar se pjesa e kërkesës së paditëses në shumën prej 2,051.90 euro e llogaritur nga e paditura për periudhën kontestuese dhjetor 2001 deri në gusht 2012 e cila shumë nuk është kundërshtuar nga paditësja është e bazuar, ndërsa shuma mbi 2,051.90 euro deri në shumën e kërkuar 2,257.09 euro nuk është e bazuar pasi që ajo nuk është e provuar me asnjë provë nga paditësja sipas parimit të barrës së provës. E paditura në rastin konkret me asnjë fakt nuk e ka provuar pretendimin e saj për parashkrimin e kërkesës së paditëses. Andaj duke u bazuar në këto që u theksuar gjykata kishte vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me datë 10 gusht 2023, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë ndaj Aktgjykimit C-IV-15-1283 të datës 19 korrik 2023, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe duke vërtetuar këtë të fundit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë dy afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Tutje, pala kundërshtare sqaron gjykatën se njoftimi që i referohet parashtruesi e informon atë se ai ka të drejtë të parashtrij kërkesën pranë AKP-së dhe se kërkesa të tilla do të shqyrtohen në likuidim. Duke injoruar plotësisht parashtruesin e palës kundërshtare dhe argumentet e saj në mbrojtje, Aktvendimi nuk përmbushë aspak detyrimin e shprehur në nenin 54 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posacme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtrësive të prezantuara gjatë procedurës. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN173-0270 të datës 25 qershor 2015.

Me datë 29 shkurt 2024, paditësja e kishte pranuar ankesën e AKP-së mirëpo nuk kishte paraqitur përgjigje.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Meritat e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin e tetë (8) pagave të papaguara në shumën prej 2,257.09 euro nga N.SH. “New Co Grand Hotel sh.p.k.”, ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se afati kohor kur paditësi kishte parashtruar kërkesën e tij për realizimin e së drejtës së tij të pretenduar, e njëjta ishte parashkruar.

Nuk është kontestuese se paditësja ishte punëtore e të paditurës . Kjo mund të vërtetohet nga provat e prezantuara nga paditësja.

Paditësja në ankesën e saj të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit kishte bashkëngjitur provat si në vijim: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN173-0270 të datës 25 qershor 2015, autorizimin për përfaqësim, kopjen e letërnjoftimit të paditëses, kopjen e librezës së punës, një njoftim për paditësen nga AKP i datës 2 shkurt 2015 me nr. prot.845/15-out, një kontratë pune me nr. 55 e datës 3 janar 2007 ndërmjet paditëses dhe të paditurës, një kontratë pune me nr. 55 e datës 3 prill 2007 ndërmjet paditëses dhe të paditurës, një kërkesë nga punëtorët e N.SH-së për AKP-në me nr. 379 e datës 9 tetor 2014, një kërkesë nga Shoqata e Pavarur Sindikale e Grand Hotel për AKP-në e datës 13 shkurt 2015 me nr. 943, një kërkesë për kompensimin e pagave, kontributeve të trustit pensionale të mbetura nga New Co Grand Hotel sh.p.k, e datës 20 shkurt 2012, një Aktvendim i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të datës 16 mars 2012, Përgjigje në shkresë e AKP-së e datës 7 gusht 2012, njoftim të datës 26 mars 2012 nga Shoqata Sindikale e Grand Hotel për AKP-në, Vendimet e Shoqatës Sindikale të Grand

Hotel të datës 2 prill 2012 dhe 27 korrik 2012, listat me kontributet e papaguara për muajin 12/2011, 2/2012- 08/2012 si dhe 12/2011 deri me 08/2012.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin e kishte aprovuar pjesërisht kërkesën e paditëses në shumën prej 2,051.90 euro për periudhën nga dhjetor 2011- gjashtë (6) gusht 2012, me arsyetimin se i njëjti kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditësit kompensimin e aprovuar, ndërsa pjesën e mbetur përtej shumës së aprovuar e kishte refuzuar si të pabazuar në mungesë të provave.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-së kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Se kërkesa nuk mund të konsiderohet e parashkruar vërtetohet edhe nga letra e AKP-së e datës 7 gusht 2012 drejtuar Sindikatës së punëtorëve me të cilën e konfirmon se ekziston një kërkesë drejtuar Sindikatës së pavarur të ndërmarrjes për shqetësimin e ngritur për mos pagesën e pagave ndaj punëtorëve dhe premtion se këto kërkesa do të shqyrtohen në proces të likuidimit.

Këto dëshmi provojnë se kërkesa nuk është parashkruar, andaj ishte i gabuar vlerësimi i AL të AKP-së se kjo kërkesë është parashkruar.

Kolegji i Apelit vlerëson së paditësja e kishte dëshmuar me lista të pagave faktin se asaj i takon kompensimi për paga të papaguara në shumën dhe për periudhën e aprovuar nga ana e shkallës së parë, shumë kjo e cila nuk ishte kontestuar as nga e paditura.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura e kishte mundësinë të kundërshtonte pretendimet e paditëses edhe në shkallë të parë mirëpo as në shkallë të dytë nuk ka paraqitur ndonjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësja, pra për të vërtetuar faktin se paditëses nuk i takon kompensimi i lartcekur

Andaj në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Numri i lëndës: 2022:234764
Datë: 19.09.2024
Numri i dokumentit: 06181725

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 19 shtator 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____